



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Shkodër, më 14/08/2020

Nr. 239/1 prot

VENDIM

Nr. 38 datë 14/08/2020

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.08.2020, bazuar në nenin 4 pika 16, në nenin 6 pika 2 germa d, në nenin 10, pika 1 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritet drejtuese dhe Senatin Akademik në USH", pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit zgjedhor z.Gasper Kokaj, për miratim si përfaqësues në KIZ pedagogun z.Adem Bekteshi dhe si vëzhgues në KZF pedagogun z.Idlir Duhaxhi,

VENDOSI:

1. Në KZFD miratohet si vëzhgues z.Idlir Duhaxhi.
2. Z.Adem Bekteshi nuk miratohet si përfaqësues i z.Gasper Kokaj, sepse kandidatët për Senat Akademik nuk mund të kenë përfaqësues në KIZ.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretare

Eugena Bisha

Arian Gjura

Sebastjan Mjekaj

Marsel Nilaj



Anëtarë

Kryetar

Fatjon NURJA

Ingrit Tirana

Megan Krahi